



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2832/1 prot.

Tiranë më 27.11.2025

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË FINANCAVE

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr.15568 prot., datë 31.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2832 prot., datë 03.11.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për krijimin e regjistrit elektronik të personave për të cilët është vendosur moslejimi për t’u futur në ambientet e lojrave të fatit apo faqe interneti, aplikacione ose platformë elektronike ku mund të luhen lojëra fati sipas kategorisë së licensuar dhe rregullave për paraqitjen, shqyrtimin, miratimin, anulimin apo refuzimin e kërkesës për moslejim, si dhe rregullave të mbajtjes e të funksionimit të regjistrit elektronik” së bashku me relacionin shpjegues.

Nga shqyrtimi i projektvendimit konstatohet se ai synon krijimin e “regjistrit elektronik” të personave për të cilët është vendosur ndalimi për t’u futur në ambientet e lojrave të fatit dhe në platformat përkatëse. Krijimi i tij bazohet në pikën 5, të nenit 6 të ligjit nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenin 4, të ligjit nr.10325. datë 23.09.2021 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Fillimisht, vërejmë se krijimi i kësaj baze të dhënash nuk synon apo përbën kërkesë për afrimi me legjislacionin komunitar (*acquis communautaire*), megjithatë do të ishte me interes të viheshim në dijeni se cilat praktika të konsoliduara të shteteve evropiane janë marrë si model për ngritjen e këtij regjistri.

Ndërkohë lidhur me analizimin e përmbajtjes së projektvendimit, propozojmë të mbahen në konsideratë disa komente dhe sugjerime si më poshtë vijon.

Në pikën 1, të pjesës II të projektvendimit togfjalëshi “...me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar” të zëvendësohet me “...me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Lidhur me sa më sipër, bëjmë me dije se, nga shkurti i vitit 2025 ka hyrë në fuqi ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”) i përafruar plotësisht me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), i cili ka shfuqizuar ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Për këto arsye, çdo grumbullim/përpunim i të dhënave personale, apo dokumentacion i hartuar duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit të ri dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Sa i përket pikës 4, të pjesës II të projektvendimit vërejmë se kur kërkesa nuk bëhet nga vetë lojtari, por nga një prej familjarëve, kërkesa mund të shoqërohet edhe me dokumente si “...vërtetim i marrëdhënies me lojtarin, ose vërtetim/deklarim që lojtari ka probleme serioze personale ose familjare (...) raporte mjekësore, vlerësime psikiatrike, vendime të gjykatës apo prova të tjera...”

Në rastet kur kërkesa bëhet nga një palë e tretë për një person madhor, ajo duhet të konsiderohet e ligjshme vetëm kur familjari ose personi tjetër disponon një akt përfaqësimi, si prokurë apo vendim gjykatë, që e autorizon të kryejë këtë veprim në emër të lojtarit, në përputhje me parimet e nenit 6 dhe kriteret e nenit 7 të Ligjit.

Megjithatë, në vijim të logjikës së vetë projektvendimit, i cili parashikon një kategori më të gjerë personash që mund të paraqesin kërkesën për llogari të lojtarit, si fëmijët e rritur apo persona që bashkëjetojnë me të, duhet bërë një ndarje më e qartë ndërmjet rasteve kur ekziston një akt përfaqësimi formal, siç është përmendur më lart. Për këto raste, gjithashtu dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë i plotë, i vlefshëm ligjërisht dhe të vërtetojë qartë lidhjen e personit kërkues me lojtarin, si dhe arsyen përse kërkesa po bëhet në vend të tij. Vetëm dokumente të tilla të verifikueshme dhe të ligjshme, së bashku me informacione të tjera të parashikuara në pikën 4 të Kreut II, mund të krijojnë bindjen e mjaftueshme pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për përfshirjen në regjistër të personit, duke garantuar respektimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, një pjesë e të dhënave të cituara më sipër në kuptim të pikës 28 të nenit 5 të Ligjit, konsiderohen si të dhëna sensitive dhe përpunimi i tyre kërkon respektimin e kushteve të veçanta të parashikuara në nenin 9 të Ligjit.

Në këtë kuadër, është e nevojshme që në projektvendim të qartësohet kjo procedurë në mënyrë që çdo veprim apo përpunim i të dhënave të kryhet në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë, duke u siguruar që të përpunohen vetëm të dhënat e nevojshme për zbatimin e legjislacionit specifik.

Lidhur **me pikën 5 të Kreut III të projektvendimit** si pjesë e “të dhënave dytësore që merren nga një bazë tjetër të dhënash” parashikohet aksesimi në të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile.

Mënyra e përpunimit të të dhënave personale të gjendjes civile, aksesit në këto të dhëna, si dhe mënyra e ndërveprimit të databazave të tjera me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile gëzojnë një rregullim të posaçëm ligjor, konkretisht bazuar në pikat 2, 2/1 dhe 3, të nenit 3, të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar.

Në këtë kontekst, detyrimet që burojnë nga dispozitat e mësipërme ligjore, janë zbërthyer me Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 *“Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”*, të Ministrisë të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për sa më lart, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, në cilësinë e kontrolluesit, në zbatim të pikës 12, të Udhëzimit të përbashkët nr. 463 2020, duhet të ndërmarrë masa për paraqitjen e kërkesës për përfshirjen e institucionit në Aneksin 1 (*Lista e institucioneve që marrin informacion, baza ligjore përkatëse, lloji dhe sasia e informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyra e vënies në dispozicion të këtij informacioni*) të këtij Udhëzimi.

Ritheksojmë që ky është një detyrim që buron nga ligji i posaçëm nr. 10129/2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar, dhe legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat parashikojnë dispozita konkrete dhe specifike, në kuadër të këtij procesi përpunimi të të dhënave personale dhe ndërveprimi i databazave me shërbimin e gjendjes civile, të cilat duhen respektuar nga çdo kontrollues.

Ndërkohë, referuar pikës 12 të projektvendimit, gjatë periudhës nga ngritja e regjistrit elektronik deri në funksionimin e plotë të tij, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit duhet të sigurojë që procesi i informimit të subjekteve të licencuara si dhe çdo formë ndërveprimi me ta, duke përfshirë aksesin siç është parashikuar, vetëm me të drejta shikimi (leximi) të të dhënave të pasqyruara në regjistër, të kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 28 të Ligjit për masat teknike dhe organizative. Këto masa përfshijnë garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave, përmes procedurave të kontrollit të aksesit, regjistrimit dhe gjurmueshmërisë së veprimeve të përdoruesve, përdorimit të kanaleve të sigurta të transmetimit/përhapjes dhe zbatimit të procedurave të qarta për menaxhimin e përdoruesve të autorizuar. Zbatimi i këtyre masave siguron ndërveprim të sigurt, proporcional dhe të ligjshëm duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe shmangien e çdo keqpërdorimi të të dhënave personale gjatë kësaj faze.

Sa më sipër, sugjerojmë që pas pikës 12 të projektvendimit të shtohet një paragraf me përmbajtje si vijon... *“Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ndërmerr të gjitha masat e nevojshme teknike dhe organizative për sigurimin e një ndërveprimi të kontrolluar dhe të mbrojtur me subjektet e licencuara, duke garantuar që çdo akses apo shkëmbim i informacionit të realizohet në mënyrë të sigurt, të dokumentuar dhe të gjurmueshme, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha fazat e ngritjes dhe funksionimit të regjistrit elektronik”*.

Në përfundim, sugjerimet e mësipërme synojnë të garantojnë zbatim sa më efektiv të legjislacioneve respektive, duke kontribuar në një kuadër ligjor dhe nënligjor sa më të qartë dhe funksional në përputhje me standardet më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi